



S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMERTIMIN "BUNA"

D U R R E S

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Buna" (shpk) Durrës veprimtarine e saj blerese, perpunuese e tregëtuese, do ta zhvilloje ne baze te ligjeve te shtetit shqiptar dhe ne baze te ketij statuti. Ajo do ti permbahet objektit per te cilen eshte krijuar dhe miratuar. Aktivitetin shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Buna" (shpk) Durrës do ta zhvilloje me pjesemarrjen e ortakeve:

1. Edmond Bujari, i biri i Khavitit, i datelindjes 1955, me çertifikate lindje Nr. 99/2-96, date 17.10.1994, me banim ne Lagjen Nr. 8, Rruga "14 Nentori" Nr. 42 Durrës, me cilesine e administratorit te shoqerise.

2. Nacci Gaetano, i datelindjes 1948, me banim ne Bari Itali, me leter njoftimi Nr. 888345458-X, me cilesine e ortakut.

KREU I -re

FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA

Neni 1

Në zbatim te Ligjit Nr. 7512, date 10.08.1991, mbeshtetur ne kreun e IV-te te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare" dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregëtar", shoqeria "Buna" (shpk) Durrës, disponon Kontrate e Themelimit te noterizuar ne Dhomen e Noterise Durrës. Ajo do te zhvilloje aktivitetin e saj sipas objektit qe ka, ne baze te ligjeve te shtetit shqiptar dhe te statutit te miratuar nga asamblea e shoqerise. Shoqeria do te veproje me regjimin e pergjegjesis se kufizuar.

Neni 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te kete emertimin "Buna" (shpk) Durrës.

Neni 3

Shoqeria "Buna" (shpk) Durrës, ka te drejte te perdore vulen e saj ne forme rrumbullake, me madhesi te zakoneshme, me mbishkrimin (Shoqeria "Buna" (shpk) Durrës Albania).

Neni 4

Selia e shoqerise "Buna" (shpk) Durrës, do te jete ne Lagjen Nr. 8, Rruga "14 Nentori" Nr. 42 Durrës, dhe me te drejte te hape filiale dhe ne qytete te tjera te Shqiperise, ku ti krijohet mundesia per ushtrimin e ketij

[Signature]

Nacci

aktiviteti.

Neni 5

Shoqeria "Buna" (shpk) Durrës, do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Prodhime zdruktharie, mobilie, divane, dýer e dritare, grila druri e metalike dhe tregetimi i tyre me shumice e pakice. Import-eksport i artikujve industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, lende ndertimi dhe tregetimi i tyre me shumice e pakice.

Neni 6

Shoqeria "Buna" (shpk) Durrës, do të ketë një kohëzgjatje mbi 11 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit të Tiranës dhe në organet financiare të Tatimit dhe Taksave të Durrës. Me pëlqimin e ortakeve të asamblese koha e kësaj shoqërie mund të zgjatet sa të shihet e arsyeshme.

Neni 7

Shoqeria "Buna" (shpk) Durrës, do të vazhdojë veprimtarinë e saj, pavarësisht nga çmimet e blerjes dhe shitjes së produkteve të gatshme, duke respektuar ligjet e ekonomisë së tregut, të kërkesës dhe të ofertës.

Neni 8

Shoqeria "Buna" (shpk) Durrës, ka të çelur numrin e llogarive në Degen e Bankës Kombëtare të Tregut të Durrës. Me rritjen e metejshme të kapitalit të saj, veprimet financiare të kësaj shoqërie mund të kryhen dhe në bankat e tjera shtetërore apo private të miratuara me ligj nga shteti shqiptar. Po ashtu ka të drejtë të veprojë dhe me bankat e shteteve të tjera.

KREU II -re

KAPITALI I SHOQËRISE, KONTRIBUTI

Neni 9

Në krijimin e saj shoqëria "Buna" (shpk) Durrës, do të ketë një kapital themeltar prej 100 000 (njëqind mijë) leke. Kjo shumë u depozitua në Degen e Bankës Kombëtare të Tregut të Durrës, duke siguruar mandatin arketim përkatës. Ky kapital mund të rritet ose të zvogëlohet. Secili ortak, për kuotën e rritjes ose të zvogëlimit të këtij kapitali, merr fitimin ose përballon humbjen. Rritja ose zvogëlimi i kapitalit duhet të bëhet me pëlqimin e tërësor të ortakeve, dhe të miratohet në mbledhjen e asamblese.

[Signature]

./..

[Signature]

Neni 10

Contributet per derdhjen e kapitalit themeltar prej 100 000 leke te behet nga ortakët:

1. Edmond Bujari me shumën 50 000 leke ose 50 per qind
2. Nacci Gaetano me shumën 50 000 leke ose 50 per qind

Kuota e kapitalit ne perqindje dhe shumat perkatese u depozituan ne Degen e Bankes Kombetare Tregtare Durres, ne emrin r sejcilit ortak.

Neni 11

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise, ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve, si dhe te pasardhesve dhe te para ardheshve. Kur kuota e kapitalit i transferohet te treteve, duhet marre me pare pelqimi i ortakut qe ka mbi 1/2 e kapitalit, dhe ne kushte jo me te favoreshme se ato qe i jane ofruar ortakut te shoqerise.

Neni 12

Per te bere te mundur vazhdimin e veprimtarise se shoqerise, perveg shumës se derdhur si kapital themeltar, disponohet dhe nje kapital tjeter i rendesishem, qe perbehet nga mjete e nevojshme per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.

Neni 13

Shoqeria "Buna" (shpk) Durres, ka te drejten e tjetersimit te pasurise se saj. Pasuria e kesaj shoqerie mbrohet nga ligjet e shtetit shqiptar, duke i krijuar kushte pune normale.

Neni 14


Shoqeria "Buna" (shpk) Durres, sipas mundesive qe mund ti krijohen dhe leverdise se saj, ka te drejte te investoje ne ndermarrje apo shoqeri te tjera private, brenda dhe jashte vendit, por gjithnje duke u mbeshtetur ne ligjet e shtetit shqiptar.

KREU III -re

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, NDARJA E TE ARDHURAVE

Neni 15

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te vitit por bilanci financiar i aktivitetit vjetor te shoqerise paraqitet ne orga-



ni financiar te Tatim Taksave Durres brenda dates 31 mars te vitit pasardhesh. Inventaret dhe operacionet financiare shqyrtohen dhe miratohen nga mbledhja e asamblese se ortakeve te shoqerise "Buna" (shpk) Durres.

Neni 16

Veprimtaria e shoqerise mbeshtetet ne te ardhurat dhe shpenzimet e kryera dhe te evidentuara ze per ze ne aktivin dhe pasivin e bilancit komercial. Rezultati financiar i shoqerise, i veprimtarise blerese, perpunuese e tregetuese qe perfshihet ne objektin e saj, shihet ne perfundim te peruidhes perkatese me daljen e bilancit periodik.

Neni 17

Mbas miratimit te bilancit vjetor, dhe te evidences se fitimeve te realizuara, mbledhja e asamblese vendos per caktimin e fondit rezerve, dhe si do te veprohet me fitimin. Fondi rezerve duhet te jete 20 per qind e fitimit vjetor. Fitimi neto perbehet nga te ardhurat e realizuara gjate vitit financiar, pasi te hiqen te gjitha shpenzimet dhe fondi rezerve i miratuar nga mbledhja e asamblese se ortakeve te shoqerise.

KREU IV -te

KONTABILITETI I SHOQERISE DHE KONTROLLI I TIJ

Neni 18

Kontabiliteti i shoqerise "Buna" (shpk) Durres, do te behet ne perputhje te plote me rregullat kontabile me ato ne fuqi ne Republiken e Shqiperi.

Neni 19

Shoqeria "Buna" (shpk) Durres, ka te drejte te marre kredi me leverdi letesuese nga institucionet bankare te Shqiperise, si dhe ne bankat e tjera jashte Shqiperise, si per financimin e investimeve, ashtu dhe per larjen e borxheve qe mund te kete ndaj shoqerise te tjera private. Por gjithnje duhet te mbeshtetur ne ligjet e shtetit shqiptar ne fuqi ne kete fushe.

Neni 20

Revizoret e caktuar nga asamblea e shoqerise, kane per detyre te vertetojne saktesine e bilanceve te shoqerise. Keta revizore duhet te veprojne sipas te njejtave rregullave te revizionimit dhe te vertetimit te bilanceve. Paga e tyre fiksohet nga asamblea e ortakeve. Ne çdo moment dhe me kerkese te cilitdo ortak, mund te caktohet nje revizor per te bere kontrolle te besueshme ne sektore te ndryshme pune, por kjo behet me kondite qe te paraloj

Edmond

./..

Na ci

me shet asamblea te pakten 8 dite para se te ushtrohet kontrolli.

Neni 21

Administratori duhet te adresoje ortakeve te shoqerise njoftimin me shkrim, fax, telefax, etj, 15 dite para se te zhvillohet mbledhja e asamblese. Krahas njoftimit duhet te dergoje raportin dhe bilancin, rezultatet e llogarise, tekstin e vendimeve te propozuara dhe raportin e revizoreve. Gjate ketyre 15 diteve, te gjitha materialet qe do te merren ne shqyrtim duhet te mbahen ne seline e shoqerise, ku sejcili nga ortaket mund ti studioje ose te marri kopje, ose te marri dijani per dokumentacionin e veprimtarise: Per bilancet, kontabiliteti i rezultateve, inventaret, raportet e parashtruara ne asamblese dhe proces verbalet perkatese.

KREU V -te

PRANIMI NE PUNE DHE DETYRIMET RECIPROKE

Neni 22

Per nevoja te prodhimit, te punes, te tregtimit, etj: shoqeria "Buna" (sh. Durrës), ka te drejte te punesoje punonjes te kualifikuar dhe punonjes te thjeshte, duke lidhur kontrata pune me sejcilin prej tyre, ose nje kontrate pune kolektive per te gjitha te punesuarit, duke u mbeshtetur ne ligjin "Per maredheniet e punes" dhe "Per sindikatat", duke i vertetuar ne Dhomen e Noterise.

Neni 23

Pagat e punes do te percaktohen nga asamblea e shoqerise, ku si baze do te jete aftesia profesionale, realizimi i normave te punes, sasia dhe cilesia e kerkuar, si dhe detyrat e tjera te percaktuara qe ne fillim ne kontraten e punes.

Neni 24

Pagesa do te behet duke aplikuar te gjitha format e kerkuara nga te punesuarit? Po ashtu punedhenesi duhet te respektoje orarin e punes ditor javore, pushimin vjetor, pushimet e dateve te festave kombetare dhe te festave fetare. Ti jape atyre te drejtat sindikale. Ne se punedhenesi nuk ka mundesi tja jape keto pushime ne ditet e caktuar, mbasi prishet procesi i prodhimit, duhet tja jape keto pushime te gjitha njeheresh, ne nje kohe qe ai do ta gjykoje te arsyeshme. Te gjitha keto duhen pasqyruar ne kontraten e punes.





Neni 25

Ne se i punesuari ben mungedha te pa justifikuara dhe te pa paralajme-
te cilet i sjellin dem ekonomik shoqerise,mbasi ne ate sektor nderp
ritet faktikisht puna,punedhenesi ka te drejte ta pushoje ate nga puna,
dhe pse kontrata e punes akoma nuk ka mbaruar.

Neni 26

Shoqeria "Buna"(shpk)Durrës,ka te drejte te kerkoje llogari dhe te ma
je qendrim ndaj atyre te punesuarve qe nuk u pergjigjen kushteve te vena
qe ne fillim te lidhjes se kontrates se punes me ta.Demet e shkaktuara per
faj te te punesuarit,zhdemtohen prej tij,deri ne vleften e plote te malli
te demtuar.

KREU VI -te

ORGANI DREJTUES,MARRJA E VENDIMEVE,ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 27

Organi vendimor i shoqerise "Buna"(shpk)Durrës,eshte asamblea e ortake
ve.Asamblea perbehet nga te gjithë ortaket qe veprone ne baze te dispozi-
tave te ketij statuti.Vendimet e marra prej tij,kur ato jane ne perputhje
te plote me ligjet dhe statutin e shoqerise,jane te detyrueshme per zbatim
nga te gjithë ortaket.Asamblea e ortakeve vendos unanimisht per ndryshime
te dispozitave te kontrates se themelimit dhe te statutit.Per rritjen ose
pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise.Per miratimin e bilancit vje-
tor.Per pushimin e veprimtarise se shoqerise,si dhe per çdo çeshtje tjeter
qe e sheh te aresyeshme.

Neni 28

Mbledhja e asamblese behet me teper se dy here ne vit.Ne raste te veça
nta mund te mbidhet dhe jashte radhe.Ne kete mbledhje jane te detyruar te
gjithe ortaket e shoqerise te marin pjese,mbasi aty do te merren vendime
nje rendesie te veçante.Vendimet e marra nga asamblea behet me votim te ha
pur dhe jo te fshehte.

Neni 29

Thirrja e asamblese behet nepermjet njoftimeve me shkrim,fax,telefax
ku permbahet dita,ora,vendi ku zhvillohet mbledhja,bendi i dites,etj.Njof-
timi dergohet jo me pake se 10 dite nga data e caktuar per mbledhje.Ortaku
mund te perfagesohet ne mbledhje nga nje person tjeter i autorizuar prej

E. Lami

./..

Na ci

tij, por kjo behet gjithnje duke u pajisur me prokure te vertetuar nga Dhoma e Noterise.

Neni 30

Asamblea ne mbledhjen e pare te saj, ku marrin pjese te gjithë ortaket pa perjashtim, zgjedh administratorin, i cili merr persiper dhe pergjigjet per mbarevajtjen e punes.

Neni 31

Asamblea e ortakeve emerone komisionin e revizionimit; Ne periudha kohe te caktuara, ky komision ushtron kontrolle mbi veprimtarine e shoqerise dhe informon asamblene e ortakeve per rezultatet e kontrollit.

KRETLI VII - re

DETYRAT E ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE

Neni 32

Shoqeria "Buna" (shpk) Durres, administrohet prej nje administratori. Por administratori mund te zgjidhet edhe nder radhet e jo ortakeve te shoqerise.

Neni 33

Administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat pa kufizime dhe perjashtime, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht asamblese se ortakeve.

Neni 34

Administratori i emeruar nga asamblea e ortakeve, zoti Edmond Bujari mban pergjegjesi ligjore per mbarevajtjen e punes ne shoqeri, dhe per zbatimin e ligjeve te shtetit shqiptar.

Neni 35

Administratori i shoqerise "Buna" (shpk) Durres, gezon te drejttat e perqesimit te shoqerise ne te gjitha organizmat shteterore, gjyqesore dhe ne ato private, si brenda dhe jashte vendit.

Neni 36

Administratori i shoqerise ka te drejten e autorizimit te nje ortaku tjeter, ose te njê personi te besuar dhe profesionalisht te pergatitur, per ushtrimin e kompetencave te veta, por ate nuk mund ta perfaqesoje me shume se nje person, dhe kjo gjithnje me prokure te vertetuar nga Dhoma e Noterise perkatese.

Edmond Bujari

Naci

Neni 37

Administratori ose ortakut qe nuk jane persona juridike, nuk u lejo-
het te kontaktoje ne çfaredo lloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria,
te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie, si dhe te behen dorezenes
apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te ku-
dert kontrata eshte e pavlefshme.

Neni 38

Administratori shkarkohet me vendim te ortakeve qe perfaqesojnë me te
per se 1/2 e kapitalit themeltar, ose me vendim te Gjykates per shkelje te
ligjeshmerise. Ne rast doreheqje, revokimi, ose te pa aftesise se administra-
torit, cilitdo qofte shkaku, ai do te ruaje funksionet e tij dhe tere push-
tetim deri ne caktimin e nje administratori tjetër ose zgjedhjen e tij.

Neni 39

Administratori, ortakut dhe cilitdo person te thërrur ne mbedhjene asa-
blëse, jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te diskutimeve te
problemeve, per burimet e furnizimit, ne veçanti te atyre te karakterit pro-
fesional, qe jane arritur me veshtiresi ne fushen e veprimtarise se shoqer

KREU VIII -re

DETYRAT DHE TE DREJTAT E ORTAKEVE

Neni 40

Te drejtat qe kane ortakët

-Drejtimin e drejte per drejte te shoqerise ne perputhje me kontraten
e themelimit dhe statutin.

Pjesemarrjen ne rezultatet e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

-Pjesemarrjen vete ose me perfaqesuesit e tyre ne organet drejtuese te
shoqerise, nepermjet autorizimit me prokure te vertetuar ne noteri.

-Njohjen me te gjitha te dhenat qe kane te bejne me veprimtarine eko-
nomike, financiare te shoqerise, me te gjitha dokumentat e perpunuara prej
saj.

-Heqjen dore nga shoqeria duhet ta beje duke i ofruar pjesen e tij te
kapitalit administratorit te shoqerise.

Detyrat qe ka ortaku i shoqerise

-Te depozitojne kuoten e tyre ose kuota suplementare ne perputhje me
kontraten e themelimit dhe me statutin e shoqerise.

Edmond ...

Haci

-Te japin te dhena te domosdoshme per realizimin e çdo objekti te veçante qe lidhet me veprimtarine e shoqerise.

-Te kryeje detyrat e caktuara per realizimin e detyrave te veprimtari-
se se shoqerise sipas objektit qe ka.

-Kur njeri nga ortakët heq dore nga shoqeria, duhet te njoftoje vendi-
min e marre prej tij, me shkrim tre muaj me pare, dhe asamblea e ortakëve
mbasi e shqyrton kerkesen e tij, i jep te drejten e largimit nga shoqeria.

-Heqja dore e ortakut, nuk e çliron ate nga detyrimet e marra me pare
ndaj shoqerise, dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj pales qe heq
dore.

-Ortaku qe heq dore vullnetarisht nga shoqeria, detyrohet ti ofroje
pjesen e tij te kapitalit ortakut tjeter te shoqerise, dhe kur ai nuk e
pranon kete, mund tja transferoje ate paleve te treta, por jo me interesa
me te ulta nga ato te ofruara ortakut tjeter te shoqerise ku bente pjese.

KREU IX -re

SHKRIRJA -LIKUJDIMI

Neni 41

Shoqeria kalon ne likujdim sapo ajo shkrihet, cilido qofte shkak.

Per nevoja te likujdimit dhe deri ne mbyllje te plote, shoqeria gezon
personalitet moral.

Likujdimi behet prej nje a me shume likujdatoreve te caktuar nga radha
e ortakëve ose jashte tyre, dhe te emeruar sipas shumices se kapitalit te
depozituar ose investuar.

Ne te njejtat kushte si likujdatore mund te emerohet dhe nje revizor.

Likujdatori ose sejcimi prej tyre, nese jane disa, perfaqeson shoqerine
ai ose ata, gezojne fuqi te plota per te realizuar aktivin dhe per te shlye
pasivin.

Kur shoqeria i jep fund veprimtarise se saj, pasurite qe i jane vene ne
dispozicion me te drejte perdorimi, i kthehen pales pronare, kurse mjetet
materiale dhe financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise
si dhe fondet e saj, ndahen ndermjet ortakëve ne perpjestim me pjesemarrjen
e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise "Buna" (shpk) Durrës.

KREU X -re

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Republika

./..

Maci

Neni 42

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis administratorit dhe ortakut midis administratorit dhe shoqerise, ose ne mareveshje me te tretet, kur nuk mund te zgjidhen me mirekuptim; atehere duhet ti drejtohen organit ligjor, gjykatave te shkalles se pare ne rrethe, dhe ne Gjykatën e Rrethit Tirane, dhe kur palet ne konflikt nuk merren vesh midis tyre, atehere kryetari i Gjykesës Rrethit Tirane, cakton nje anetar te trete perballe dy kundërshtarëve per zgjidhjen e problemit ne rruge ligjshmerie.

Neni 43

Ndryshimet dhe plotesimi i metejshem i ketij statuti, behet me te njejtën menyre proceduriale me te cilën eshte nxjerre ky statut. Persa nuk eshte shprehur dhe parashikuar ne kete statut, duhet ti referohemi ligjit per shoqerite tregëtare dhe legjislacionin ne fuqi.

Neni 44

Ky statut hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit te tij para noterit te Dhomës se Noterise Durrës, nga ortaket.

Neni 45

Ky statut u pergatit ne Durrës me . . . 1996, ne pese kopje ne gjuhem shqipe dhe italiane dhe kane te njejtën permbajtje ligjore.

ADMINISTRATORI

Edmond Bujari

Edmond Bujari
Edmond Bujari

ORTAKU

Nacci Gaetano

Caetano Nacci
Nacci

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

Nr. Rep. 294 Nr. Kol. 260

V E R T E T I M

Sot me datën /4.2.1996 para meje noterit publik A. Turku, u paraqiten zoterinjte Edmond Bujari me cilesine e administratorit te shoqerise "Buna" (shpk) Durrës, dhe Nacci Gaetano me cilesine e ortakut te shoqerise. Me zotesi te plote proceduriale per te vepruar, te cilet nenshkruan statut me vullnetin e tyre te plote. Une noteri vërtetoj.....



NOTERI
Alf Turku



KONTRATE THEMELIMI

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMERTIMIN "BUNA" (SHPK)

D U R R E S

E themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Buna" (shpk) Durres,ne ortaket:

1.Edmond Bujari,i biri i Xhavitit,i datelindjes 1955,me certifikate lindje Nr.99/2-96 dt. 17.10.1994,me banim ne Lagjen Nr.8,"Ruga "14 Nentori" Nr.42 Durres,me cilesine e administratorit te shoqerise.

2.Nacci Gaetano,i datelindjes 1948,me banim ne Bari Itali,me karta d'identità(leter njoftimi)Nr.888345458-X,me cilesine e ortakut.

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Buna"(shpk)Durres,do te zhvilloje aktivitetin e saj,ne baze te ligjeve te shtetit shqiptar dhe te vete statutit te shoqerise.

Neni 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te kete emertimin "Buna" (shpk) Durres.

Neni 3

Selia e shoqerise "Buna" (shpk) Durres,do te jete ne Lagjen Nr.8 "Ruga "14 Nentori" Nr.42 Durres.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise "Buna"(shpk)Durres,do te jete: Prodhime zdruktharie,mobilie,divane,dyer e dritare,grila druri e meta like dhe tregetimi i tyre me shumice e pakice.Import-eksport i artikujve industriale,ushqimore,bujqesore,blegtorale,lende ndertimi dhe tregetimi i tyre me shumice e pakice.

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "Buna"(shpk)Durres,do te jete mbi 11 vjet,duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe ne organet financiare te Tatim Taksave Durres.Me pelqimin e ortakeve te asamblese kjo kohe mund te zgjatet sa te shihet e arsyeshme.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise "Buna"(shpk)Durres,do te jete 100 000(njeqind mije) leke,per kete do te kontribojne ortaket:

Edmond Bujari

Nacci

1.Edmond Bujari me shumen 50 000 leke ose 50 per qind

2.Nacci Gaetano me shumen 50 000 leke ose 50 per qind

Kjo shume u derdh ne Degen e Bankes Kombetare Tregtare Durres ne emrin e sejcilit ortak.

Neni 7

Cdo ortak do te perfitoje ne perqindje ne varesi me kapitalin e depozituar ne Degen e Bankes Kombetare Tregtare Durres.

Neni 8

Shpenzimet per themelimin e shoqerise me pergjegjesise se kufizuar me emertimin "Buna" (shpk)Durres,do te perballohen nga ortaket ne menyre te barabarte.

Neni 9

Veprintaria blerese,perpunuese dhe tregtuese,mbrohet me dispozita te veçanta ligjore dhe nen ligjore nga shteti shqiptar.

Neni 10

Cdo ortak i shoqerise eshte i detyruar te ruaje karakterin e fshehte te veprimtarise se shoqerise dhe te dokumentacionit te saj.

Neni 11


Cdo ortak pergjigjet individualisht per demet qe mund ti shkaktoje shoqerise se rezultat i veprimtarise dhe mos veprimtarise te kryer me dashje apo nga pakujdesia,qe kane sjelle si pasoje nje dem ekonomik. Ortaku qe ka shkaktuar demin eshte i detyruar te zhdemtoje ate deri ne vleften e plote te mallit te demtuar,me perjashtim te rasteve te fatkeqsive te medha,si termete,permytje dhe fenomene te tjera.

Neni 12

Ne se gjate aktivitetit te veprimtarise se shoqerise,do te lindi nevoja per ndryshime ne kontraten e themelimit,keto do te behen ne kushte te njejta dhe menyre proceduriale,me anen e se ciles eshte perpiluar kjo kontrate.

Neni 13

Per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne mes ortakeve ose ne marrëdhënie ne te tretet do ti drejtohen organit ligjor per ti zgjidhur ne rruge ligjeshmerie. ./..



Neni 14

Ortakët janë të detyruar:

Te zbatohen detyrat e percaktuara ne statutin e shoqerise dhe kontratat qe do te lidhen per çdo operacion pune.

Te zbatohen kerkesat ligjore te kontabilitetit te miratuar nga shteti shqiptar.

Neni 15

Kjo kontrate themelimi merr fuqi ligjore pasi te jete nenshkruar nga ortakët para noterit te Dhomes se Noterise.

Neni 16

Kjo kontrate themelimi u perpilua ne Durres me . .1996 ne pese kopje ne gjuhen shqipe dhe italiane dhe kane te njejten perbajtje ligjore

ADMINISTRATORI

Edmond Bujari

ORTAKU

Nacci Gaetano

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr.Rep. 294 Nr.Kol. 260

V E R T E T I M

Sot me daten 14.2.1996, para meje Ali Turku, noter prane Dhomes se Noterise Durres, u paraqiten zoterinjte Edmond Bujari me cilesine e administratorit dhe Nacci Gaetano me cilesine e ortakut. Identitetin e te parit e vertetova me ane te çertifikates se lindjes ndersa te te dytit me ane te letres se njoftimit (Karta d'identità), me zotesi te plote proceduriale per te vepruar. Pasi e lexuan kontraten e themelimit nen per nen dhe ne teresi dhe pasi e gjeten te rregullt e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te li

Une noter vertetoj.....

N O T E R I

Ali Turku



13820/12

01.03.02

27 FEB 2002
27.02.2002
[Signature]

9

K E R K E S E

KERKUESI Edmond Bujari banues ne Durrës, administrator i shoqërisë tregëtare "BUM" shpk



OBJEKTI Depozitimin pranë rregjistrit tregëtar të Gjykatës së shkalles së parë të vendimit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë tregëtare "BUM" shpk.

GJYKATES E SHKALLES SE PARE

TIRANE

Por shprehur qendrimin e tyre...
27.02.2002
Edmond Bujari
27.02.2002
27.02.2002

Reshtet e vendimit nr 13820 date 16.2.1996 reshtet rregjistruar si perso juridik shoqëria tregëtare "BUM" shpk.

Vendimin e asamblese së ortakëve të kësaj shoqërie reshtet vendosur largimi nga kjo shoqëri së ortakëve Macci Gaetano dhe shitje e kuotes së kapitalit përmasën 50% përmasë 50.000 leke ortakëve ngalet i veterane këte shoqëri z. Edmond Bujari.


Kerrojme depozitim e ketij vendimi pranë rregjistrit tregëtar të Gjykatës së shkalles së parë të Tiranës.

KERKUESI
EDMOND BUJARI

[Signature]

V E N D I T

Nr. 1 date 26.2.2009



I ASAMBLESE SE ORTAKVE TE SHOCERISE "BUNA" TREGETAR

" BUNA " SH.PK

Ne asambleje e ortakve te shocerise " BUNA " shpk e parbane nga ortakut z. Edmond Bujari dhe Nacci Gaetano ne mbledhjen e dates 26.2.2009 unanimisht dhe ne verezitje kemi vendosur:

1. Lirpisin nga kjo shoceri e ortakut Nacci Gaetano duke ju shitur kuota e kapitalit ortakut Edmond Bujari ne mases 50 % beraz kjo me 50.000 leke te kapitalit fillestar.

Shoceria ngelet ne ortak te vetem z Edmond Bujari dhe me kapital fillestar 100.000 leke

Meritojme te depozitojme kete vendim prane Drejtoriat tregetar te Qarkut se shkalles se pare Tjerran.

ORTAKUT E SHOCERISE TREGETAR
" BUNA " SH.PK

NACCI GAETANO

ED. GOND BUJARI

REPUBLIKA E SHqipërisë
KOMITETI QENDRORE I KURSES
Nr. 995 Rep



KOMITETI QENDRORE I KURSES

Me vendim të datës 06.03.1996 për neje
votërit u bashkëpunua për kontrastin e shpërndarjes së
kuotave të kapitalit si më poshtë :

SHITESI Nacchi Gaetano i dtl. 1948 banues në
Itali shpërndarës me pasaportë nr. 888345556, meqë me zotësi
te plote juridike për te vepruar.

BLERESI Edmond Bujari i biri i Kshavitit i
dtl. 1955 banues në Durres zrugë 14 mentorit nr. 42
meqë me zotësi te plote juridike për te vepruar.

Shitesit Nacchi Gaetano dhe blerësit Edmond Bujari
jane ortakë te shoqërisë tregëtare "BUNA" shpk e
regjistruar si person juridik me vendimin nr. 13820
date 16.2.1996, me kapital fillestar 100.000 leke.

Me vendimin e asamblese se ortakëve te
kesaj shoqërie eshte vendpsur te largohet nga kjo
shoqëri ortakut Nacchi Gaetano, dhe ti shitet kuota e
kapitalit ne masen 50% baraz kje me 50.000 leke ortakut
që ngelet i vetem ne kete shoqëri z. Edmond Bujari.
Pasi u be dhe shlyerja e detyrimit perkates, qe nga
ky moment shoqëria ngelet me nje ortak ku te gjitha
te drejtat dhe detyrimet e shoqërisë iax ncelen z. Edmond
Bujari, dhe ortakut qe largohet Nacchi Gaetano zhvishet nga
te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i perkasin
shoqërisë.

SHITESI
NACCHI GAETANO

BLERESI
ED. OHD BUJARI

Nacchi

ROBERT
KAZERI MURATI

Robert

Edmond Bujari

13820/2
10.09.02

J.F. Boy
12.03.2002
12 MAR. 2002

KERKESE

KERKUES :1.Edmond Bujari i biri i Xhavitit, i dtl 1955, banues ne Durres, Lagja 8 Rrugja
"14 Nendori" Nr.42 madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me
cilesine e administratorit te shoqerise "Buna" sh.p.k,


KERKUES :2.Artur Bujari i biri i Xhavitit, i dtl 1956, banues ne Durres,Lagja 8 Rrugja
"14 Nendori" Nr.22 madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me
cilesine e administratorit te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k,

- Objekti :**
- 1. Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit Nr.3, date 8.3.2002 te Ortakut
te Vetem te shoqerise "Buna" sh.p.k.
 - 2. Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit Nr.2, date 8.3.2002 te
Asamblese Ortakeve te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k.

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Me vendimin nr. 13820, dt. 16.02.1996 eshte regjistruar si person juridik
shoqeria tregtare "Buna"sh.p.k. Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit te saj, ajo ka
qene krijuar nga dy ortak: Edmond Bujari dhe Nacci Gaentano, ndersa me vendimin nr. 13820/1
1.02.2002 pas shitjes se aksioneve nga Nacci Gaentano z. Edmond Bujari, mbetet Ortak i
Vetem dhe administrator z. Edmond Bujari; me kapital themelitar 100.000 leke ,

Me vendimin nr.14244 dt.20.03.1996 eshte regjistruar si person juridik
shoqeria tregtare "Albitaflex" sh.p.k. Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit te saj, ajo
ka qene krijuar nga Ortaket Astrit Duci, Artur Bujari, Antonio de Marinis dhe Giuseppe
Saracino, ndersa me vendimin nr.14244/1 date 07.07.1999 dhe vendimin nr.14244/3 date
...2002 mbi baze kontrate shitesh te aksioneve krijuar Z. Astrit Duci dhe
Artur Bujari, Giuseppe Saracino, Antonio de Marinis me kapital themelitar
100.000 leke , me administrator z. Artur Bujari



Organet vendimmarrese te te dyja shoqerive konkretisht per shoqerine "Buna"
sh.p.k Ortaku i Vetem dhe per shoqerine "Albitaflex" Asambleja Ortakeve me vendimet e
tyre respective nr.3 date 8.3.2002 dhe nr.2 date 8.3.2002 kane vendosur:

- 1. Te pranohet bashkimin e shoqerise "Albitaflex" me shoqerine "Buna" sh.p.k. ne formen
e perthithjes se saj ku shoqeria "Buna" eshte perthithese dhe shoqeria "Albitaflex" eshte
e perthithura.
- 2. Miratimin e projektit te bashkimit. (nezhkelidhur vendimit)
- 3. Caktimin e z.Gani Limana, "Ekspert Kontabel i Autorizuar", per te bere vleresimin e
kapitalit te shoqerise "Buna" sh.p.k dhe te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k.
- 4. Ngarkohen administratorit per depozitimim ne regjistrin tregtar.
Ne keto kushte keskojne depozitimim e ketyre ndryshimeve prane regjistrin
tregtar.

Handwritten notes and signatures:
1) miratimi i bashkimit
2) miratimi i projektit
3) miratimi i caktimit te ekspertit
...
E. Bujari
A. Bujari

KERKUESIT

Edmond BUJARI

Artur BUJARI

PROJEKT

PER BASHKIMIN E SHOQERIVE



"BUNA" sh.p.k. DHE "ALBITAFLEX" sh.p.k.

Me vendimin nr. 13820, dt. 16.02.1996 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "BUNA" sh.p.k.

Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit te saj, ajo ka qene krijuar nga ortakët Edmond Bujari dhe Nacci Gaetano, me kuota Edmond Bujari 50% dhe Nacci Gaetano 50%, ndersa me Vendimin nr. 13820/16 date 1.3.2002 pas shites s kuota nga Nacci Gaetano Z. Edmond Bujari, mbetet Ortak i Vetem Z. Edmond Bujari me 100% te aksioneve, me kapital themeltar 100.000 leke, me administrator z. Edmond Bujari.

Me vendimin nr. 14244, dt. 20.03.1996, eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "ALBITAFLEX" sh.p.k. Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit te saj, ajo ka qene krijuar nga ortakët Astrit Duci, Artur Bujari, Antonio de Marinis dhe Giuseppe Saracino, me kapital themeltar 100.000 leke, me kuota te barabarta nga 25 % sejcili dhe me administratore Astrit Duci e Giuseppe Saracino. Ne baze te vendimit nr. 14244/1 date 07.07.1999 dhe vendimit nr. 14244/3 date _____ mbi baze kontrate shite kuotash eshte larguar nga shoqeria Astrit Duci dhe shelen ortak ~~Artur Bujari~~, 33,33% Giuseppe Saracino 33,33% dhe Antonio Marinis me 33,33% administrator Z. Artur Bujari.

Pas bisedimesh paraprake organet vendimore te dy shoqerive kane rrene dakort per bashkimin e shoqerive me keto kushte :

1. **Bashkimi** do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare "Buna" sh.p.k. do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare "Albaitaflex" sh.p.k. do te jete shoqeria e perthithur.
2. **Ortake** te shoqerise se krijuar do te jene , Edmond Bujari, Artur Bujari dhe Giuseppe Saracino.
3. **Emri i shoqerise** se krijuar nga bashkimi do te jete "Buna" sh.p.k.
4. **Setia e shoqerise** se krijuar do te jete ne Durres, Lagja 14 Shkozet.
5. **Pergjindjet** e sejcilit ortak ne kapitalin e ri te krijuar nga bashkimi do te percaktohen pas paraqites se raportit nga Eksperti Kontabel i Autorizuar ne mbledhjen e ardheshme te asamblese.
6. **Te drejtat dhe detyrimet** e shoqerise "Albaitaflex" sh.p.k. do t'i kalojne shoqerise "Buna" sh.p.k.

Edmond BUJARI

Artur BUJARI

Giuseppe SARACINO

ANTONIO DE MARINIS

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGETARE "Albitaflex" sh.p.k.



VENDIM

NR. 2, DATE 9. 3. 2002

Sot ne mbledhjen e dates 9. 3. 2002, Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k. mori ne shqyrtim projektin e bashkimit (perthithjes) me shoqerine "Buna" sh.p.k., ne te cilin shoqeria "Buna" sh.p.k. do te jete perthithesja dhe shoqeria "Albitaflex" sh.p.k. do te jete e perthithura.

Pasi diskutoi projektin Asambleja e Ortakeve , ne perputhje me statutin dhe ligjin

VENDOSI:

1. Te pranoje bashkimin me shoqerine "Buna" sh.p.k. ne formen e perthithjes me te.
2. Miratimin e projektit te bashkimit. (bashkelidhur vendimit)
3. Caktimin e Ekspertit Gani Limanaj "Ekspert Kontabel i Autorizuar" per kryerjen e aktit te ekspertimit lidhur me proceduren e bashkimit me perthithje te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k. me "Buna" sh.p.k.
4. Depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregetar.

ORTAKET E SHOQERISE

Artur BUJARI

Saracino GIUSEPPE


Antonio De MARINIS

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1470 REP.

VERTETIM

Sot me date 8. 3. 2002, para meje noterit publik Nezir Murati, me adrese Rr."B.Curri", u paraqiten zoterinjte e sipershenuar madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaportat respective 216917, 120953 L dhe 207312 M dhe nen cilesine e ortakeve te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k, te cilet me deklaruan se dokumentin e mesiperm e kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tyre te lire dhe e nenshkruajne ate para meje. Une noterit e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI
/ Nezir MURATI /



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGETARE "BUNA" sh.p.k.



VENDIM

NR. 3, DATE 2.3.2001

Sot ne mbledhjen e dates 2.3.2002, une Edmond Bujari, Ortaku i Vetem i shoqerise "Buna" sh.p.k. mori ne shqyrtim projektin e bashkimit (perthithjes) me shoqerine "Albitaflex" sh.p.k., ne te cilin shoqeria "Buna" sh.p.k. do te jete perthithesja dhe shoqeria "Albitaflex" sh.p.k. do te jete e perthithura.

Pasi diskutoi Ortaku i Vetem i saj, ne perputhje me statutin dhe ligjin

VENDOSI:

1. Te pranoje bashkimin me shoqerine "Albitaflex" sh.p.k. ne formen e perthithjes se saj.
2. Miratimin e projektit te bashkimit. (bashkelidhur vendimit)
3. Caktimin e Ekspertit Gani Limanaj "Ekspert Kontabel i Autorizuar" per kryerjen e aktit te ekspertimit lidhur me proceduren e bashkimit me perthithje te shoqerise "Buna" sh.p.k. me "Albitaflex" sh.p.k.
4. Ngarkohet administratori per depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregetar.

ORTAKU I VETEM

Edmond Bujari

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 472 REP.

VERTETIM

Sot me date 2.3.2002, para meje noterit publik Nezir MURATI, me adrese Rr."B.Curri", u paraqit personalisht z.Edmond Bujari, i identifikuar prej meje nepermjet pasaportes perkatese me cilesine e Ortakut te Vetem te shoqerise "Buna" sh.p.k, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperme e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI

/ Nezir MURATI /



3 M Dopp
13 of 1992
13 MAG 2002



KERKESE

- KERKUES** :1.Edmond Bujari i biri i Xhavitit, i dtl 1955, banues ne Durres,Lagja 8 Rruqa "14 Nendori" Nr.42 madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise "Buna" sh.p.k,
- KERKUES** :2.Artur Bujari i biri i Xhavitit, i dtl 1956, banues ne Durres,Lagja 8 Rruqa "14 Nendori" Nr.22 madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k,

- Objekti** :
1. Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit Nr.4,date 30.04.2002 te Ortakut te Vetem te shoqerise "Buna" sh.p.k.
 2. Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit Nr.3,date 30.04.2002 te Asamblese Ortakeve te shoqerise "Albitaflex" sh.p.k.

GJYKATES SE SHKALLES PARE TIRANE

Me vendimin nr. 13820, dt. 16.02.1996 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "Buna" sh.p.k. Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit te saj, ajo ka qene krijuar nga dy ortak: Edmond Bujari dhe Nacci Gaentano,ndersa me vendimin nr. 13820/1 01.03.2002 pas shitjes se aksioneve nga Nacci Gaentano z.Edmond Bujari,mbetet Ortak i Vetem dhe administrator z.Edmond Bujari; me kapital themeltar 100.000 leke,

Me vendimin nr.14244 dt.20.03.1996 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "Albitaflex" sh.p.k Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit te saj ka qene krijuar nga Ortaket Astrit Duçi,Artur Bujari,Antonio de Marinis/ dhe Giuseppe Saracino,ndersa mbi baze kontrate shitje aksionesh eshte larguar Z.Astrit Duçi duke mbetur ortaket Artur Bujari Giuseppe Saracino dhe Antonio De Marinis; me kapital themeltar 100.000 leke , me administrator z. Artur Bujari

Aktualisht Ortaku i Vetem i shoqerise "Buna"sh.p.k. me vendimin e tij Nr. 4 date 03.04.2002 ka vendosur

1. Miratimin e Raportit te Ekspertit Kontabel per caktimin e kontributeve ne natyre te shoqerive "Albitaflex" sh.p.k dhe "Buna" sh.p.k.
2. Emertimi i shoqerise do te jete "Buna" sh.p.k.
3. Selia e shoqerise do te jete ne Durres, Lagja 14 Shkozet.
4. Hartimi i nje Statuti dhe Akt themelimi te ri per shoqerine"Buna" sh.p.k.
5. Perqindjet e kapitalit ne shoqerine e re do te jene Edmond Bujari 50%,Artur Bujari 16.66% , Giuseppe Saracino 16.66% dhe Antonio De Marinis 16.66%
6. Administrator i shoqerise do te jete z. Edmond Bujari.
7. Ngarkohet administratori per depozitimim e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.

Aktualisht Asambleje e Ortakeve te shoqerise "Albitaflex"sh.p.k. me vendimin e saj Nr. 4 date 30.04.2002 ka vendosur

1. Miratimin e Raportit te Ekspertit Kontabel per caktimin e kontributeve ne natyre te shoqerive "Albitaflex" sh.p.k dhe "Buna" sh.p.k.
2. Emertimi i shoqerise do te jete "Buna" sh.p.k.
3. Selia e shoqerise do te jete ne Durres, Lagja 14 Shkozet.
4. Hartimi i nje Statuti dhe Akt themelimi te ri per shoqerine"Buna" sh.p.k.

Handwritten notes and signatures:
30.04.2002 te
Asamblese Ortakeve
herb...
Nenshtetimi Nr. 3 dt
30.4.2002
Albitaflex ortakeve
dt. 30.4.2002
dt. 30.5.2002
Shabur dt 30.7.2002
M. Dopp
Hoff